



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA BELSH

KRYETARI

URDHËR
Nr. 3781 Datë 08/12/2021

PËR
MIRATIMIN E RREGULLORES PËR HETIMIN ADMINISTRATIV TË
SINJALIZIMIT DHE MBROJTJEN E KONFIDENCIALITETIT NË
INSTITUCIONIN E BASHKISË SË BELSHIT

Në mbështetje të nenit 8 pika 2, nenit 64, shkronja "a" të ligjit nr. 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore", ligjit nr. 60/2016, Per sinjalizimin dhe mbrojtjen e sinjalizuesve", Ligjit nr. 44/2015. "Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë" dhe vendimit nr. 816, datë 16.11.2016 të Keshillit të Ministrave "Për strukturën, kriteret e përzgjedhjes dhe marrëdhëniet e punës së punonjësve të njësisë përgjegjëse në autoritetet publike, në zbatim të ligjit nr. 60/2016. "Për sinjalizimin dhe mbrojtjen e sinjalizuesve".

URDHËROJ:

1. Miratimin e rregullore "Për hetimin administrativ të sinjalizimit dhe mbrojtjen e konfidencialitetit në institucionin e Bashkisë së Belshit", sipas dokumentit bashkëlidhur dhe pjesë përbërëse e këtij urdhri.
2. Ngarkohet për zbatimin e kësaj rregulloreje njësi përgjegjëse në Bashkinë Belsh.
3. Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.



KRYETARI
Arif TAFANI



RREGULLORE
PËR HETIMIN ADMINISTRATIV TË SINJALIZIMIT DHE MBROJTJEN E
KONFIDENCIALITETIT NË INSTITUCIONIN E BASHKISË SË BELSHIT

Belsh, _____

KREU I RREGULLA TË PËRGJITHSHME

Neni 1 **Baza ligjore**

Rregullorja për hetimin administrativ të sinjalizimit dhe mbrojtjen e konfidencialitetit në Bashkinë e Belshit, bazohet në ligjin nr. 60/2016, “Për sinjalizimin dhe mbrojtjen e sinjalizuesve”, Kodin e Procedurave Administrative, Vendimit nr. 816, datë 16.11.2016 të Këshillit të Ministrave “Për strukturën, kriteret e përzgjedhjes dhe marrëdhëniet e punës së punonjësve të njësisë përgjegjëse në autoritetet publike, si dhe në bazë të urdhërave, udhëzimeve dhe akteve të tjera nënligjore të miratuara nga Kryetari i Bashkisë Belshit.

Neni 2 **Objekti**

Objekti i kësaj rregulloreje është përcaktimi i rregullave për procedurën e shqyrtimit të hetimit administrativ të sinjalizimit dhe përcaktimin e mekanizmave të mbrojtjes së konfidencialitetit në zbatim të ligjit nr. 60/2016 “Për sinjalizimin dhe mbrojtjen e sinjalizuesve”.

Neni 3 **Përkufizime**

Në këtë Rregullore termat e mëposhtëm kanë këto kuptime:

1. “I sinjalizuar” janë një ose më shumë persona, ndaj të cilëve bëhet një sinjalizim, sipas këtij ligji, në lidhje me një veprim ose praktikë të dyshuar korrupsioni.
2. “Njësia përgjegjëse” është organi i posaçëm, i caktuar brenda autoritetit publik i përbërë nga një ose më shumë punonjës të njesisë që menaxhojnë burimet njerëzore dhe i ngarkuar me detyrën e shqyrtimit të hetimit administrativ të sinjalizimit dhe shqyrtimin e kërkesës për mbrojtjen e sinjalizuesit, sipas përcaktimeve të këtij ligji.
3. “Organizatë” është autoriteti publik ose subjekti privat.
4. “Sinjalizim” është raportimi i informacionit nga ana e sinjalizuesit tek njësia përgjegjëse ose ILDKPKI-ja për veprime apo praktika të dyshuara korrupsioni, të kryera në vendin e tij të punës në autoritetin public.

5. “Sinjalizues” është individi, i cili aplikon ose është në marrëdhënie pune, ose ka punuar më parë pranë autoritetit public, pavarësisht nga natyra e marrëdhënies së punës ose kohëzgjatjes së saj, si dhe nëse paguhet ose jo, që sinjalizon një veprim ose praktikë të dyshuar korrupsioni.
6. “Veprim ose praktikë e dyshuar korrupsioni” është një veprim ose mosveprim, fakte ose rrethana të kryera në një organizatë, për të cilat sinjalizuesi dyshon në mirëbesim, sipas këtij ligji, se mund të përbëjë korrupsion.

KREU II
VEPRIMTARIA E NJESISË PËRGJEGJËSE NGRITUR PRANË
BASHKISË BELSH

Neni 4

Parimet e veprimtarisë

1. “Njesia përgjegjëse” ngritur pranë B.B për zbatimin e ligjit nr. 60/2016 “*Për sinjalizimin dhe mbrojtjen e sinjalizuesve*”, bazohet në parimin e:
 - a. ruajtjes së konfidencialitetit të informacionit të sinjalizimit dhe sekretit shtetëror;
 - b. njohjes së identitetit të sinjalizuesit, përveç rastit kur ligji lejon pranimin e një sinjalizimi anonim;
 - c. sinjalizimit vullnetar të një veprimi ose praktike të dyshuar të korrupsionit;
 - d. integritetit dhe paanshmërisë gjatë shqyrtimit të sinjalizimit;
 - e. zbatimit të mekanizmave të efektshëm dhe të përshtatshëm për mbrojtjen e të drejtave dhe interesave legjitimë të sinjalizuesit;
 - f. procedurës së hetimit administrativ të sinjalizimit në mënyrë të shpejtë dhe të besueshme.

KREU III
PROCEDURAT E VEPRIMIT

Neni 5

Kryerja e veprimeve procedurale

1. Veprimet procedurale të “Njesisë Përgjegjëse” kryhen në përputhje me ligjin nr. 60/2016 dhe në rast të mosparashikimit nga ky ligj sipas Kodit të Procedurave Administrative.
2. Njoftimet për veprimet procedurale, për të cilat “Njësia Përgjegjëse” cakton afate, duhet të përmbajnë paralajmërimin e shprehur mbi pasojat e mosrespektimit të afatit.

Neni 6

Forma dhe përmbajtja e sinjalizimit

1. Sinjalizimi bëhet me çdo mjet komunikimi, në formë të shkruar ose deklarohet verbalisht para

punonjësit të caktuar të “Njesisë Përgjegjëse” dhe dokumentohet me shkrim prej këtij të fundit.

2. Sinjalizimi përmban të paktën:
 - a. të dhënat e identitetit të sinjalizuesit;
 - b. të dhënat e kontaktit të sinjalizuesit;
 - c. përshkrimin e fakteve e të rrethanave të njohura nga sinjalizuesi për veprimin ose praktikën e dyshuar të korrupsionit, shoqëruar me provat përkatëse, për aq sa është e mundur;
 - d. referimin përkatës në Kodin Penal të Republikës së Shqipërisë, për aq sa është e mundur, nga sinjalizuesi, të veprës ose praktikës së dyshuar të korrupsionit;
 - e. në rastin e sinjalizimit tek “Njësia Përgjegjëse”, shkaqet ligjore dhe rrethanat e faktit, për aq sa është e mundur, nga sinjalizuesi, për përdorimin e mekanizmit të sinjalizimit të jashtëm.
3. Sinjalizuesi mund të zgjedhë të mbetet anonim dhe sinjalizimi pranohet nga “Njësia Përgjegjëse” si i tillë, vetëm nëse në të janë shprehur qartë dhe janë arsyetuar shkaqet e anonimatit dhe të dhënat e sinjalizuara sigurojnë një bazë të mjaftueshme për të hetuar administrativisht veprimin ose praktikën e dyshuar të korrupsionit.
4. Në rastet kur sinjalizimi nuk është depozituar sipas formës dhe përmbajtjes së mësipërme sinjalizuesit i kërkohet me shkrim të korrigjojë këto të meta brenda 7 ditëve nga data e marrjes së njoftimit për korrigjim.

Neni 7

Mosfillimi i hetimit administrativ

1. “Njësia Përgjegjëse” ka të drejtë të mos fillojë hetimin administrativ nëse;
 - a. sinjalizimi nuk është depozituar sipas formës dhe përmbajtjes së kërkuar dhe sinjalizuesi nuk korrigjon këto të meta brenda 7 ditëve nga data e marrjes së njoftimit për korrigjim;
 - b. sinjalizimi përmban fakte dhe rrethana që nuk përfshihen në fushën e zbatimit të ligjit nr. 60/2016, sipas nenit 3, pika 6, të tij;
 - c. kur nga përmbajtja e sinjalizimit del haptazi se nuk ka elemente të kundërvajtjes administrative ose të veprës penale.
2. Mosfillimi i hetimit administrativ bëhet me vendim të arsyetuar të “Njesisë Përgjegjëse”

KREU IV

HETIMI ADMINISTRATIV

Neni 8

Regjistrimi i sinjalizimit

1. Sinjalizimet regjistrohen në një regjistër të posaçëm protokollit dhe elektronik për regjistrimin e

sinjalizimeve.

2. “Njësia Përgjegjëse” nuk mund të refuzojë për asnjë shkak regjistrimin e sinjalizimit.

Neni 9

Parimet e hetimit administrativ nga “Njësia Përgjegjëse”

1. Në kryerjen e hetimit administrativ “Njësia Përgjegjëse” vepron:
 - a. me ndershmëri, paanshmëri dhe efikasitet, duke pasur parasysh interesat legjitim të sinjalizuesit;
 - b. në mënyrë të pavarur nga pikëpamja politike dhe çdo influencë tjetër e padrejtë që mund të pengojë realizimin e detyrave;
 - c. duke shmangur çdo konflikt interesi të mundshëm përpara fillimit të hetimit administrativ;
 - d. duke marrë të gjitha masat e përshtatshme për të mbrojtur dokumentacionin dhe provat lidhur me sinjalizimin nga zhdukja, fshehja, ndryshimi, falsifikimi dhe veprime të tjera, të cilat synojnë asgjësimin e tyre;
 - e. duke ruajtur konfidencialitetin e informacionit dhe të mbrojtë të dhënat në përmbajtje të çdo sinjalizimi;
 - f. duke ruajtur sekretin shtetëror në përmbajtje të një sinjalizimi, në zbatim të ligjit.

Neni 10

Procedura e hetimit administrativ

1. “Njësia Përgjegjëse” heton administrativisht sinjalizimin, në përputhje me procedurën e përcaktuar në ligjin nr. 60/2016. Për aq sa nuk parashikohet ndryshe në këtë ligj, njësia apo ILDKPKI-ja zbaton dispozitat e Kodit të Procedurave Administrative.
2. “Njësia Përgjegjëse” ka të drejtë të kërkojë informacione dhe dokumente, të urdhërojë inspektive ose analiza, të mbledhë deklarata ose të pyesë persona në dijeni ose rrethanat e çështjes ose të konsultohet me ekspertë të fushave të ndryshme.
3. Në hetimin administrativ merr pjesë sinjalizuesi dhe çdo person tjetër i tretë, kur dyshohet se posedon dokumente ose ka dijeni për rrethanat e sinjalizuara, përfshirë dhe të sinjalizuarin, nëse vlerësohet e nevojshme nga “Njësia Përgjegjëse”
4. Çdo palë pjesëmarrëse në hetimin administrativ i garantohet një proces i rregullt, në përputhje me parashikimet në Kodin e Procedurave Administrative, si dhe:
 - a. mund të japë deklarata me shkrim, argumente ose opinione;
 - b. mund të konsultohet me dosjen e hetimit;

c. ka të drejtë të dëgjohej në lidhje me pretendimet e tij.

5. “Njësia Përgjegjëse” njofton sinjalizuesin për çdo masë të marrë në përgjigje të sinjalizimit jo më vonë se 30 ditë nga momenti i kryerjes së veprimit. Pavarësisht nga afati i njoftimit të parashikuar në këtë pikë, “Njësia Përgjegjëse” është e detyruar t’i përgjigjet brenda 30 ditëve nga marrja e kërkesës për informacion, të paraqitur me shkrim nga sinjalizuesi, në çdo kohë, në lidhje me çështjen e sinjalizuar prej tij.
6. “Njësia Përgjegjëse” merr masa të menjëhershme, të çastit dhe për aq sa është e mundur, për të parandaluar ose penguar vazhdimin e pasojave të dëmshme nga veprimi ose praktika e dyshuar e korrupsionit të sinjalizuar.
7. Nëse në përfundim të hetimit administrativ nga “Njësia Përgjegjëse” rezulton se veprimi ose praktika e dyshuar e sinjalizuar përbën ose mund të përbëjë një shkelje administrative, sipas ligjit, “Njësia Përgjegjëse”, sipas rastit, vë në dijeni organin kompetent- ILDKPKI-në

Neni 11

Provat në hetimin administrativ

1. “Njësia Përgjegjëse”, dokumenton çdo veprim që kryen gjatë hetimit administrativ. Dokumentet e nevojshme për hetimin administrativ merren apo pranohen pa pagesë. Çdo shkelje e detyrimit të zyrtarëve apo të organizatave private për dhënie dokumentacioni shkresor apo dokumenti tjetër provues përbën shkak për fillimin e procedimit ligjor në varësi të shkeljes së konstatuar.
2. Punonjësit e “Njesisë Përgjegjëse”, kanë të drejtë të këqyrin sende, vende apo dokumentacion me qëllim fiksimin dhe dokumentimin e veprimeve apo të pasojave të veprimtarisë apo praktikës së dyshuar të korrupsionit. Dokumentimi mund të bëhet me procesverbal, me mjete të tjera fotografike e filmike apo në çdo mënyrë tjetër.
3. Në raste të veçanta, kur punonjësit e “Njesisë Përgjegjëse”, vlerësojnë se ekzistojnë rrethanat për manipulimin apo asgjësimin e dokumenteve shkresore, bllokojnë dokumentacionin apo mjetet e tjera provuese. Zyrtarët përgjegjës apo personat e tjerë janë të detyruar të mos kryejnë asnjë veprim mbi këto dokumente gjatë gjithë kohës që ato janë të bllokuara. Në çdo rast mbahet një procesverbal, që nënshkruhet nga anëtarët e njesisë përgjegjëse apo personat e tjerë. Zhblllokimi i dokumentacionit bëhet me akt të lëshuar e nënshkruar nga të gjithë anëtarët e organit të posaçëm.
4. Gjatë ushtrimit të detyrës punonjësit e “Njesisë Përgjegjëse” zbatojnë, për aq sa mund të jetë e përshtatshme, të gjitha mjetet dhe mënyrat provuese të parashikuara në Kodin e Procedurave Administrative.
5. Në fund të kontrollit mbahet akt-kontrolli, i cili nënshkruhet nga punonjësit e “Njesisë

Përgjegjëse” Në rast se këta të fundit nuk janë dakord me përmbajtjen e aktit kanë të drejtë të bëjnë vërejtje dhe të paraqesin kundërshtime. Kopje të argumenteve dhe të dokumenteve kundërshtuese i bashkëlidhen aktit.

Neni 12

Përfundimi i hetimit administrativ

1. “Njësia Përgjegjëse” përfundon hetimin administrativ nëse:
 - a. gjatë hetimit rezulton se sinjalizimi për veprimin ose praktikën e dyshuar të korrupsionit është i bazuar. Në këtë rast, “Njësia Përgjegjëse” njofton menjëherë prokurorinë ose Policinë e Shtetit.
 - b. sinjalizuesi nuk ka vepruar në kushtet e mirëbesimit, në zbatim të nenit 6 të ligjit nr. 60/2016.
2. Në dosjen e sinjalizimit shënohen vendimi për përfundimin e hetimit administrativ “Njësia Përgjegjëse” i arsyetuar për të gjitha shkaqet që kanë çuar në vendimmarrjen përkatëse, si dhe masat e marra në lidhje me sinjalizimin.

KREU V

RUAJTJA E KONFIDENCIALITETIT DHE TË DHËNAVE PERSONALE

Neni 14

Konfidencialiteti

1. Gjatë procedurës së hetimit administrativ të sinjalizimit identiteti i sinjalizuesit u bëhet i ditur personave të tretë vetëm me pëlqimin e tij me shkrim.
2. “Njësia Përgjegjëse” duhet të ruajë në çdo kohë në mënyrë konfidenciale informacionin e lidhur me sinjalizimin, duke mos e përhapur ose transmetuar tek persona të tretë, si dhe të mos e përdorin për qëllime të tjera, përveçse me pëlqimin me shkrim të sinjalizuesit ose për përmbushjen e një detyrimi ligjor.
3. “Njësia Përgjegjëse”, në komunikimet me organizatën ku punon sinjalizuesi ose me çdo subjekt apo autoritet tjetër, privat ose shtetëror, respekton detyrimin e konfidencialitetit dhe ua komunikon informacionin e nevojshëm vetëm personave të caktuar për hetimin administrativ ose për marrjen e masave për ndjekjen e fakteve të sinjalizuara, në kuadër të një marrëveshjeje konfidencialiteti mes palëve.

Neni 14

Mbrojtja e të dhënave personale

1. Të dhënat personale të individëve të përfshirë në hetimin administrativ përpunohen vetëm për

qëllim të ligjit nr. 60/2016. Në çdo rast, përpunimi i të dhënave personale kryhet sipas parimeve dhe procedurave të legjislacionit në fuqi për mbrojtjen e të dhënave personale.

2. Në rastet kur, në zbatimin e këtij ligji, konstatohet mosrespektim i legjislacionit për mbrojtjen e të dhënave personale, çështja i referohet Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale.

KREU VII AFATI PËR PROCEDURËN E HETIMIT ADMINISTRATIV

Neni 15 **Afati për vendimmarrjen**

1. Procedura e hetimit administrativ të sinjalizimit nga “Njësia Përgjegjëse” përfundon sa më shpejt të jetë e mundur, por, në çdo rast, jo më vonë se 60 ditë nga data e fillimit të hetimit, përveçse kur nga rrethanat kërkohet një afat më i gjatë.
2. Shtyrja e afatit për hetimin administrativ bëhet me vendim të arsyetuar të “Njesisë Përgjegjëse” duke përcaktuar edhe afatin e ri kohor të shtyrjes në përputhje me vështirësinë dhe kompleksitetin e çështjes.

Kjo Rregullore hyn në fuqi menjëherë.